



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of
Prishtina



Drejtoria e Shërbimeve Publike

Në mbështetje të nenit 62 Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në përputhje me nenin 3 (paragrafi 2) dhe nenit 4 të Rregullores nr. 01-030/01-236535/23 për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës, Drejtoria për Shërbime Publike njofton si vijon:

THIRRJE
PËR PAJISJEN ME LEJE PËR OPERIMIN E PARKINGJEVE PRIVATE
NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS

Të gjithë personat juridik, përkatësisht operatorët e parkingjeve private ekzistuese dhe subjektet që synojnë organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve private në territorin e Komunës së Prishtinës, në kuptim të nenit 3 dhe nenit 4 të Rregullores nr. 01-030/01-236535/23 për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja), ftohen t'i nënshtrohen procedurës për pajisje me *Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste të parkingjeve*.

1. Dokumentet e nevojshme që duhet t'i bashkëngjiten kërkesës

Në përputhje me nenin 4 (paragrafi 5) të Rregullores, kërkesës për pajisje me leje duhet t'i bashkëngjiten:

- 5.1 Certifikata e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse;*
- 5.2 Marrëveshja ose kontrata e noterizuar me pronarin/pronarët e ligjshëm për shfrytëzimin e hapësirës së caktuar si vendparkim;*
- 5.3 Projekti për kyçje dhe funksionet e hapësirës së vendparkimit, i hartuar nga inxhinieri i komunikacionit rrugor;*
- 5.4 Dëshmia për numrin e vendparkimeve, ku hapësira duhet të ketë së paku 10 vendparkime;*
- 5.5 Dëshmia se kyçja nuk bëhet në rrugë e cila ka më tepër se dy shirita për kahje të njëjtë të lëvizjes;*
- 5.6 Dëshmia se parkingu ka qasje direkte në rrugë dhe se qasja nuk kalon përmes trotuarit;*
- 5.7 Dëshmia për shenjëzimin horizontal dhe vertikal;*

5.8 Dëshmia për shtrimin e hapësirës me kubëza betoni ose asfalt;

5.9 Dëshmia për posedimin e sistemit të kamerave.

1. Taksa

Taksa për dhënien e lejes si në nenin 4 do të jetë:

Për marrjen e Lejes së përgjithshme të operimit, secili aplikues duhet të paguajë taksën e përgjithshme në vlerë prej 1000.00 euro dhe Taksën vjetore për secilin vendparkim sipas nenit 4 (paragrafi 11) të Rregullores. ZONA I (qendra e qytetit) — 100.00 euro për një vendparkim. I ZONA II - 50.00 euro një vendparkim. ZONA III për periudhën prej dy (2) vitesh prej hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të lirohet nga kjo taksë.

2. Procedura, leja dhe kohëzgjatja

- Shqyrtimi i aplikimeve bëhet nga komisioni i themeluar nga Kryetari i Komunës, i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë për Shërbime Publike, Drejtorisë së Inspektionit dhe Drejtorisë së Urbanizmit.
- Pas verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Rregullore, Drejtoria për Shërbime Publike lëshon Lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste të parkingjeve.
- Leja lëshohet për periudhë me mundësi deri në gjashtë (6) vite nga momenti i pajisjes me leje.
- Revokimi i lejes bëhet në rastet kur konstatohet se subjekti nuk i përmbush më kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Rregullore.

4. Obligimet e operatorit të parkingut privat

Operatorët e parkingjeve private janë të obliguar:

- Vërtetimin ose faturën që kenë përmbushur të gjitha obligimet për tatimin në pronë ndaj Komunës së Prishtinës, si për subjektin afarist ose personin fizik, ashtu edhe për pronën komunale apo private që shfrytëzohet si hapësirë parkimi.
- Të operojnë në përputhje me kushtet dhe kriteret mbi bazën e të cilave janë pajisur me leje;
- Të mirëmbajnë hapësirën e parkingut dhe pajisjet përcjellëse;
- Të sigurojnë që shfrytëzimi i parkingut të mos pengojë lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe sigurinë në komunikacion;
- Të përdorin sistemin e kamerave në pajtim me legjislacionin në fuqi.



5. Mbikëqyrja

Mbikëqyrja e përmbushjes së kushteve dhe kritereve për operimin e parkingjeve private bëhet nga organet kompetente të Komunës së Prishtinës, në pajtim me Rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

6. Vendi dhe afati i aplikimit

Aplikimet dorëzohen në formë digjitale në platformën;
<https://aplikimet.prishtinaonline.com> më së largu deri më 31/08/2026 në ora 16:00.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të merren në shqyrtim.

**Drejtorja e Shërbimeve Publike
Kryeqyteti Prishtinë**

